

Si te beheni PARTNERE te TMC Training Management Consulting Ltd

TMC ofron mundesine e **Partneritetit** me eksperte te cilet duan te angazhohen si **Konsulente, Trajnere apo Auditore** te Sistemeve te Menaxhimit bazuar ne Modelet dhe Standartet e ofruara nga Organizata Nderkombetare e Standarteve ISO, Fondacioni European per Menaxhimin e Cilesise EFQM, Komitetet Europiane per Standartizimin CEN dhe CENELEC.

Procesi i partneritetit zhvillohet si me poshte:

1. Dergimi nga i interesuari nje CV (shqip apo anglisht) dhe i Dokumentacionit mbeshtetes lidhur me eksperiencat ne fushen e Standardeve ISO/EFQM/CE MARK dhe/ose eksperiencat profesionale qe perputhen me to.
2. Vleresimi i Dokumentacionit nga TMC
3. Percaktimi i nevojës per Trajnim per te interesuarin duke identifikuar Trajnimet e nevojshme, kohen dhe kostot perkatese per aplikantin.
4. Aplikanti do te duhet me pas te kryejë Trajnimet e dakortesuara dhe te kalojë me sukses testimet perkatese.
5. Pas perfundimit te hapave me siper TMC i ofron Partnerit mundesine e bashkepunimit duke percaktuar termat operacionale dhe financiare sipas parimeve me poshte:

5.1 Per pjesen operacionale nenshkrhet midis TMC dhe Partnerit nje dokument i quajtur „Marreveshje Bashkepunimi“ me objektiva konkrete dhe te dakortesuara,

„Marreveshja e Bashkepunimit“

i jep te drejta Partnerit:

- a. Te perdore Referencat e TMC kur kerkon Kliente
- b. Te perdore database e projekteve te ngjashme te TMC
- c. Te perdore ambientet dhe infrastrukturen e punes se TMC

e detyron Partnerin:

- d. Te realizoje me perpikeri dhe ne kohen e rene dakort Projektet sipas Metodikes, Mjeteve dhe Etikes se punes se TMC
- e. Te ruaje konfidencialitetin lidhur me Projektet e realizuara duke nenshkruar dokumentin e „**Marreveshjes se Konfidencialitetit me TMC**“.
- f. Te zbatoje te gjithë detyrimet qe rrjedhin nga **Manuali i Personelit** te TMC

5.2 Per pjesen financiare marredhenia TMC-Partner funksionon parimisht si me poshte:

Per cdo Projekt nenshkrhet nje dokument i quajtur „**Kontrata tekniko-financiare per Projektin _____**“ midis TMC dhe Partnerit lidhur me **Vleren, Termat e Pageses dhe Kohen e Projektit**.

TMC do te monitorije qe vlerat e Projekteve qe ndermerr Partneri te jene gjithmone brenda kufijve normale te biznesit qe TMC ofron ne treg.

Kontratat per cdo projekt do te nenshkrhen nga TMC. Faturimet e Projekteve do te kryhen nga TMC permes faturave me TVSH.

TMC i paguan Partnerit sa me poshte:

- a. 65% te Vleres se Projektit pa TVSH, nese Partneri e kryen plotesisht vete Projektin duke mos perdorur asetet njerezore apo ambientet e punes se TMC.
- b. Nese Partneri kerkon bashkepunim teknik me TMC atehere raporti financiar midis TMC dhe Partnerit per projektin ne fjale percktohet rast pas rasti.
- c. Ne rast se Partneri perdor ambientet e punes se TMC atehere do te paguaje per overheads 10% te Vleres qe ai perfiton nga Projekt.
- d. Transferta e pageses tek Partneri nga TMC do te behet sipas Termave te Pageses te percaktuara paraprakisht ne **Kontraten tekniko-financiare per Projektin _____**.
- e. Ne cdo rast transferta do te kryhet ne rruge bankare. Partneri do te paguaje Taksat perkatese si Individ (tatim ne burim mbajtur dhe kryer nga TMC) ose taksat qe rrjedhin nga biznesi i tij i regjistruar.

Dergoni CV-ne, Kontaktet tuaja apo Pyetje ne adresen tone te emailit info@tmc-al.com dhe ju do te kontaktoheni brenda 72 oreve.

Ju falenderojme dhe mirepresim te Aplikoni ne cdo te kohe !!